



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI JURIDIK**

PROJEKTVENDIM

NR.____, DATË__/_/_/ 2022

**“PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E SUBJEKTIT TË
KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE DATË
28.06.2022, LIDHUR NDËRMJET BASHKISË Durrës , MINISTRISË SË ENERGJISË
DHE INFRASTRUKTURËS DHE BASHKIVE SHIJAK, KRUIË, KAVAJË,
RROGOZHINË”.**

Në mbështetje të nenit 113, të Kushtetutës, të Nenit 9, dhe të pikës 1 dhe 5, të Nenit 14 e vijues të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, Marrëveshjes për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjiellës-Kanalizimeve datë 28.06.2022, lidhur ndërmjet Bashkisë Durrës dhe MIE dhe Bashkive Shijak, Krujë, Kavajë, Rrogozhinë si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Të miratojë Marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjiellës-Kanalizimeve datë 28.06.2022, lidhur ndërmjet Bashkisë Durrës dhe MIE dhe Bashkive Shijak, Krujë, Kavajë, Rrogozhinë.
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e tij si Aksionar i vetëm i “Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sha”, që në përputhje me kushtet dhe dakordësinë e arritur në Marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjiellës-Kanalizimeve datë 28.06.2022 , që pas krijimit të Subjekteve me Kompetenca të Përbashkëta ku Bashkia do të jetë aksionare, të vijojë me miratimin në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionarëve të autorizimit për Administratorin e “Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime

Durrës sha” për nënshkrimin e çdo akti të nevojshëm kontraktor dhe noterial me qëllim transferimin e plotë të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë asetet që aktualisht shoqëria ka , për tek shoqëria e re SKP-UK që do të krijohet.

3. Ngarkohet kryetari i Bashkisë Durrës dhe Shoqëria Aksionare e Ujësjetllës-Kanalizimeve Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

PËR DREJTORINË LIGJORE

Zëvendëskryetar

Elio Jani

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Drejtör

Ardian Iljazaj

KRYETAR

Emiriana Sako